

RIFINITURA



DEKOFIN

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë, Gri	25 KG	3.7kg/m ² për 3mm trashësi

PËRSHKRIM

Produkt me baze cemento për realizimin e rifiniturave në mure të brëndshme, tavane dhe fasada. I përshtatshëm për të gjitha tipet e bazamenteve me bazë çimento-gëlqere. I papërshtatshëm për tu vendosur direkt mbi bazamente me bazë gipsi apo te lyera me pare me boje. Karakterizohet nga një punueshmeri shumë e mire, mbulueshmëri e larte dhe transpirante.

FUSHA E APLIKIMIT

Mbi të gjitha tipet e bazamenteve me bazë çimento-gëlqere dhe gëlqere-çimento si: llaçra me mbushje tradicionale dhe me llaçra të parapërgatitur. Shtresë me një ose dy duar për tavane, mureve të brëndshme dhe të jashtme.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT





Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Bazamentet me aftësi të lartë thithje duhet të lagen paraprakisht përpara aplikimit të produktit.

APLIKIMI

Përzjeni me një përzjerës elektrik 7-7.5 litra ujë me DEKOFIN në një enë të pastër, deri sa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni produktin në qetësi për 10 minuta dhe më pas përzjejeni përsëri përpara përdorimit. Apliko-ni produktin me një mallë dhe bëni nivelimin e saj, në një trashësi prej 3 mm. Pas 10-15 min fërkojeni sipërfaqjen me përdaf derisa të nxirrni kokrrizën. Nuk është i aplikueshëm mbi sipërfaqje gipsi. Kushtet atmosferike ndikojnë në kohën e tharjes së produktit.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Mënyra e aplikimit: Nji ose dy duar
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg	Aplikimi i bojës: 20 ditë
Ngjyra: E bardhë, Gri	pH i përzierjes: 13
Konsumi: 3.7 kg/m ² (3mm trashësi)	Granulometria: 0.7mm
Ruajtja: Ne paleta druri	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Magazinimi: 12 muaj nga data e prodhimit	Forca në shtypje: 6.6N/mm ²
Masa vëllimore: 1.4-1.5 gr/cm ³	Thithja e ujit: WO
Sasia e ujit: 7-7.5 litra ujë per 25 kg produkt	Konduktiviteti termik: 0.53 λ 10,dry
Trashësia: 1-2 mm/dorë	Reaksioni ndaj zjarrit: A1 Class



Kujdes! Nuk rekomandohet aplikimi i finos ne suporte me fleksibilitet të lartë si sistemi kapot apo produkte te tjera fleksibel , ne sipërfaqe te paqëndrueshme ose ne disnivele të mëdha . ! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund te ndryshojne karakteristikat e punimit te produktit (ngadalsim ose pershpëjtim ne tharje te produktit). Mos e përdorni në:

- Suporte druri,metali, PVC apo sipërfaqe të tjera jo me bazë çimento.
- Në ambiente ku ka lagështirë të vazhdueshme,
- Suporte që karakterizohen nga vibrime të paqëndrueshme.
- Në temperatura të larta, të ulëta, me erë të fortë.